



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA POGRADEC  
KËSHILLI

Nr. 1102 Prot.

Pogradec, më 13.03. 2023

**Lënda:** Rezultatet e Sondazhit të Prioriteteve të Komunitetit, të Bashkisë Pogradec

**Drejtuar:** Z. Ilir Xhakolli, Kryetar i Bashkisë Pogradec

**Për dijeni:** Anëtarëve të Këshillit Bashkiak të Bashkisë Pogradec

I nderuar Z. Kryetar,

Komisioni i Ekonomisë dhe i Financës, i mbledhur në datën 13 mars 2023, pasi shqyrtoi rezultatet e sondazhit për prioritetet e komunitetit për Tavanet Përgatitore Buxhetore të PBA 2024-2026, kërkon reflektimin në Tavanet Buxhetore të prioriteteve që kanë dalë nga ky sondazh.

Sondazhi i hartuar dhe organizuar nga Këshilli Bashkiak Pogradec, i publikuar në faqen WEB dhe FB të Këshillit bashkiak, ka si qëllim të sjellë zërin qytetar dhe të grupeve të interesit pranë pushtetit lokal dhe mundësisht të përfshijë këto prioritate në Projektbuxhetin Afatmesëm 2024-2026, brenda kapaciteteve financiare dhe prioriteteve strategjike të Planit të Përgjithshëm Vendor.

Këshilli i Bashkisë, pasi shqyrtoi rezultatet e sondazhit vëren se funksionet e përfshira në programet e mëposhtme, janë konsideruar prioritare nga shumica e të anketuarve në sondazh.

- Papunësia arsim dhe aftësim
- Turizmi
- Mbështetje për zhvillimin ekonomik
- Sport dhe argetim
- Kujdesi për personat e sëmurë dhe me aftësi të kufizuara,
- Shërbim 6 Planifikim urban vendor
- Strehimi

Për sa më sipër, rekomandojmë përfshirjen e këtyre prioriteteve në Tavanet Përgatitore Buxhetore për PBA 2024-2026 të Bashkisë Pogradec. Bashkia të marrë parasysh dhe të reflektoje prioritetet e komunitetit.

Komisioni mirëpret reagimin Tuaj në lidhje me prioritetet e komunitetit, dhe reflektimin e tyre në Tavanet Buxhetore 2024-2026.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

**Kryetari i Këshillit Bashkiak: Sotiraq Mangëri**

**Kryetar I Komisionit të Ekonomisë dhe Financave: Celnik Haxhillari**

**Sekretare e Këshillit Bashkiak: Jona Bojko**



ANALIZA E SONDAZHIT NE LIDHJE ME PRIORITETET E PUBLIKUT PER  
PROJEKTBUXHETIN AFATMESEM 2024-2026

## QELLIMI DHE ECURIA E SONDAZHIT

Ky sondazh ka si qëllim të mundësojë pjesëmarrjen qytetare në vendimarrje duke mbledhur mendimin e komunitetit mbi mënyrat se si bashkia I ka shpenzuar paratë gjatë vitit 2022, si dhe të ndihmojë këshillin bashkiak të kuptojë se cilat janë prioritetet kryesore të komunitetit ne lidhje me buxhetin afatmesëm 2024-2026. Sondazhi merr mendimin edhe në lidhje me performancën e shërbimeve kryesore si dhe në lidhje me gatishmërinë për të paguar më shumë tarifa për të përmirësuar shërbimet që ofrohen.

Bazuar në rezultatet e këtij sondazhi Këshilli Bashkiak Pogradec ka hartuar një shkresë përcjellëse në lidhje me kërkesat prioritare të komunitetit për shpenzime buxhetore, e cila mendohet të ndihmojë administratën në përcaktimin e tavaneve përgatitore.

Pyetjet e sondazhit bazohen në të dhënat faktike të vitit 2022 dhe shpenzimet për shërbimet kryesore gjatë 2023.

Pyetsori është shpallur në Faqen Web dhe FB të Këshillit bashkiak Pogradec në dt 05/02/2023 dhe ka qëndruar online deri më datë 07/03/2023


## REZULTATET E SONDAZHIT

## TE DHENA TE PERGJITHSHME

116 Persona kanë plotësuar pyetëSORIN nga njësi administrative të ndryshme, nder të cilët 42 meshkuj dhe 74 femra.

## 1. Përcaktoni gjininë tuaj


● Femër	74
● Mashkull	42



Pjesëmarrësit në sondazh, të cilët kanë plotësuar pyetëSORIN vijnë nga njesite administrative Pogradec, Bucimas, Cerrave, Velcan, Hudenisht, Trebinje. Për më shumë referojuni tabelës më poshtë:

2. Përcaktoni rezidencën tuaj


<input checked="" type="radio"/> Pogradec	87
<input type="radio"/> Buçimas	17
<input type="radio"/> Çërravë	5
<input type="radio"/> Dardhas	0
<input type="radio"/> Hudenisht	2
<input type="radio"/> Preptisht	0
<input type="radio"/> Trebinjë	1
<input type="radio"/> Velçan	4



Pjesa më e madhe e pjesëmarrësve 57, I përkasin grupmoshës 31-45 vjec. 18 I përkasin moshës 18-30 vjec, 38 I përkasin moshës 46-60 vjec dhe 3 persona, moshës mbi 60 vjec.

3. Përcaktoni ciles grupmoshe i perkisni


<input checked="" type="radio"/> 18-30 vjeç	18
<input checked="" type="radio"/> 31-45 vjeç	57
<input checked="" type="radio"/> 46-60 vjeç	38
<input checked="" type="radio"/> mbi 60 vjeç	3



Pjesëmarrësit vijnë nga sektorë të ndryshëm të ekonomisë. 6 pjesëmarrës vijnë nga shtresat në nevojë. Në tabelën më poshtë gjeni numrin e personave sipas statusit të punësimit, të cilët kanë plotësuar pyetesorin. Pjesa më e madhe e personave që e kanë plotësuar janë të punësuar në sektorin publik, 6 janë të punësuar në sektorin privat, 3 janë student dhe staf akademik ose nga OJF.

4. Une jam (Zgjidhni njerin nga opsionet)


<input checked="" type="radio"/> I vetëpunësuar	5
<input type="radio"/> I punësuar në sektorin privat	1
<input checked="" type="radio"/> I punësuar në sektorin publik (...)	101
<input type="radio"/> Punonjës OJF / Akademik	1
<input type="radio"/> Student	2
<input type="radio"/> I papunë	3
<input type="radio"/> Tjetër	3



Kanë plotësuar sondazhin 4 persona të cilët marrin ndihme ekonomike, dhe 1 person me aftësi të kufizuara

5. Ju lutem cilesoni nese jeni brenda ketyre kategorive te perfshirjes sociale

- Merrni ndihmë ekonomike 4
- Jeni person me aftësi të kufizu... 1




#### OPINIONI NE LIDHJE ME SHPENZIMET BUXHETORE PER SHERBIMET KRYESORE

Qytetarët janë shprehur në lidhje me shpenzimet buxhetore për shërbimet kryesore në Bashki, në diagramin më poshtë: Ata shprehin dakordësinë në lidhje me financimin e shumicës së shërbimeve, ndërkohë që mendojnë se duhet të shpenzohen më shumë Për arsimin baze përfshire arsimin parashkollor, Për rrjetin rrugor rural, Për kujdesin social për familjet dhe fëmijët.

6. A jeni dakord me mënyrën se si janë shpenzuar paratë për shërbimet më të financuara listuar më poshtë? Shprehni opinionet tuaja në lidhje me këte. (mbi 5% e buxhetit)

- Jam dakord
- Duhet shpenzuar më shume
- Duhet shpenzuar më pak
- Nuk e di




KESHILLI BASHKIAK BASHKIA POGRADEC

Në lidhje me performancën e bashkisë për shërbimit kryesore të ofruara, sikurse vihet re nga grafiku më poshtë, ka një dakordësi të shumicës së pjesëmarrësve për financimin e shërbimeve kryesore, por kërkohen më shumë financime për Rrjetin rrugor rural.

7. Si e vlerësoni performancën e bashkisë për shërbimet kryesore të ofruara?

■ Shume mire ■ Mire ■ Jo mire ■ Nuk e di




PRIORITETET E KOMUNITETIT NE LIDHJE ME BUXHETIN 2024

Sikurse duket nga përgjigjet e pyetjes 8, programet më prioritare për komunitetin janë: Papunësia arsim dhe aftësim, Turizmi, Mbështetje për zhvillimin ekonomik, Sport dhe argëtim, Kujdesi për personat e sëmurë dhe me aftësi të kufizuara, Planifikim urban vendor, Strehimi.

8. Prioritetet e Komunitetit

Zgjidhni ato shërbime për të cilat mendoni se duhet shpenzuar më shumë (5% ose më pak është shpenzuar)

- Planifikimi Urban Vendor 38
- Strehimi 33
- Arsimi Profesional 29
- Papunesia, arsim dhe aftësim 68
- Sigurimi shoqëror 12
- Shërbimet Bujqësore 32
- Mbështetje për Zhvillimin Eko... 49
- Kujdesi për Personat e Semurë... 37
- Shërbimet e tregjeve dhe insp... 22
- Të tjera 6
- Policia Vendore 7
- Turizmi 53
- Transporti Publik 25
- Sport dhe argëtim 39
- Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojt... 21
- Option 16 1



Si rezultat, shërbimet më prioritare ku bashkia duhet të shpenzojë më shumë para sipas qytetarëve janë:

Shërbim 1 Papunësia arsim dhe aftësim

Shërbim 2 Turizmi

Shërbim 3 Mbështetje për zhvillimin ekonomik

Shërbim 4 Sport dhe argetim

Shërbim 5 Kujdesi për personat e sëmurë dhe me aftësi të kufizuara,

Shërbim 6 Planifikim urban vendor

Shërbim 7 Strehimi

### GATISHMERIA PER TE PAGUAR ME SHUME TAKSA PER SHERBIMET KRYESORE

Shumica e pjesëmarrësve në sondazh janë dakort të paguajnë më shumë taksa për shërbime më cilësore në lidhje me Kopshtet dhe çerdhet, Gjelbërimin e mirëmbajtjen e varrezave dhe hapësirave të tjera publike.

10.

A jeni të gatshëm të paguani më shumë taksa / tarifa për përmirësimin e shërbimeve të ofruara?

■ Po ■ Jo

Për menaxhimin e mbetjeve



Për gjelbërimin, mirëmbajtjen e varrezave dhe hapësirave të tjera publike



Për furnizimin me ujë




Për ujitjen dhe kullimin



Për shërbime të tjera (pyjet dhe kullotat, zjarrfikësen, parkimin, përdorimin e hapësirave publike, et



Për kopshtet dhe çerdhet



100%

0%

100%

Faleminderit!